REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE DHE TERRITORIT

PROJEKT-VENDIM

NR 70 DATË 20 / 11 /2025

"PËR LEJIM TË SHFRYTËZIMIT TË HAPËSIRËS PUBLIKE ME QËLLIM BIZNESI BAR-KAFE/FAST FOOD DHE RESTORANT, PËRGJATË PEDONALES TË QYTETIT TË BILISHTIT PA PEDANË, VETËM VENDOSJE TË TENDAVE PA MBËSHTETËSE DHE CADRAVE SI DHE NDALIMIN E VENDOSJES TË CADRAVE DHE TAVOLINAVE NË TROTUARIN NË KRAHUN E DJATHTË QË NGA SHESHI I QYTETIT DERI NË RRETH-RROTULLIMIN NË RRUGA E MIRASIT"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligji nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar, Ligji 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Vendimin nr.1096 datë 28.12.2015 "Për miratimin e rregullave , kushtet e procedurave dhe menaxhimin e hapësirës publike"

PROPOZOJ:


1. Lejimin e shfrytëzimit të hapësirës publike me qëllim biznesi bar-kafe/fast food dhe restorant, përgjatë pedonales të qytetit të Bilishtit pa pedanë.
2. Vendosjen e tendave pa mbështetëse por të fiksuara vetëm në mur dhe përdorimin e cadrave.
3. Cadrat dhe tendat të jenë me ngjyrë vishnjë dhe me skelet metalik me ngjyrë gri. Përmasat e cadrave të jenë 260cm X 260cm dhe tenda me përmasa 300 cm X 300 cm.
4. Ndalimin e vendosjes të cadrave dhe tavolinave në trotuarin në krahun e djathtë që nga sheshi i qytetit deri në rreth-rrotullimin në rruga e Mirasit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Civile dhe Territorit.
6. Ky vendim do të hyjë në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të ligjit nr.139/2015 data 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

Konceptoi: Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes Civile dhe Territorit
Marsel Mulla

Konfirmoi bazën ligjore: Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve
Eriksela Avdo

KRYETARI I BASHKISE
EDUARD DURO

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35583123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com






NË
ZAMIRI
fast food & pizza
PIZZA
HAMBURGER
GJIRO
SANDWICH
BYREK
LAKROR
DONER

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE DHE TERRITORIT

Nr.3693 Prot. **Datë 20/11/2025**

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

"PËR LEJIM TË SHFRYTËZIMIT TË HAPËSIRËS PUBLIKE ME QËLLIM BIZNESI BAR-KAFE/FAST FOOD DHE RESTORANT, PËRGJATË PEDONALES TË QYTETIT TË BILISHTIT PA PEDANË, PA TENDË POR VETËM VENDOSJE TË CADRAVE DHE TAVOLINAVE SI DHE NDALIMIN E VENDOSJES TË CADRAVE DHE TAVOLINAVE NË TROTUARIN NË KRAHUN E DJATHTË QË NGA SHESHI I QYTETIT DERI NË RRETH-RROTULLIMIN NË RRUGA E MIRASIT"

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Bashkisë Devoll!

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligji nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar, Ligji 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Vendimin nr.1096 datë 28.12.2015 "Për miratimin e rregullave , kushtet e procedurave dhe menaxhimin e hapësirës publike", po ju paraqesim relacionin mbi projekt-vendimin si më poshtë:

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit për lirimin e hapësirave publike të zëna nga bizneset të cilët kishin shfrytëzuar hapësirën publike duke vendosur pedana në funksion të aktivitetit të tyre privat strukturat pranë bashkisë në bashkëpunim me bizneset bënë të mundur heqjen e tyre duke liruar hapësirat publike.

Në funksion të veprimtarisë dhe mbështetjes të bizneseve gjykojmë të arsyeshme që bizneset të mund të vendosin cadra dhe tenda sipas specifikimeve teknike të përmendura në projekt-vendim.

Gjithashtu duke qënë se trotuari i ndodhur në krahun e djathtë që nga sheshi i qytetit deri në rreth – rrotullimi në rruga e Mirasit është i ngushtë dhe zbatimi i këtij projekt vendimi prej bizneseve do të sillte ngushtimin e tij kërkojmë që në këtë pjesë të ndalohet vendosja e tendave dhe çadrave përgjatë tij.

Konceptoi: Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes Civile dhe Territorit
Marsel Mulla

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com